



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Nj o f t i m P u b l i k

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05nr.350/02–12435/25 dt.23.01.2025, në emër të kërkuarit: Pronarit, Gani Krasniqi nga Prishtina, dhe Investitorit “Suisse Company” nga Prishtina, me certifikatë të biznesit ARBK 811382043, dhe me përfaqësues ligjor Mustafa Havolli nga Podujeva, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore dhe afariste - **Ndërtesa “1”** me 2B+P+12, në kuadër të Parcelës ndërtimore të Bllokut urban **“F2-1”**- Tërësisë Hapësinore **“F2”** të Plani Rregullues të Hollësishëm "Kalabria", 2024-2032 në Prishtinë, konkretisht parcelën kadastrale, **nr.2855-37 ZK Prishtinë**.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **19.02.2025** deri më **04.03.2025**, në e-mail adresën: **urbanizmi@prishtine@rks-gov.net**.

Kushtet e propozuara të ndërtimit – Ndërtesa: “1” me 2B+P+12	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	“Arë e klasit 2” / Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	7.5m & 10m nga vija rregulluese
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	~ 40m’/16m’ & 40m’/15m’
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësor dhe të pasmë të parcelës kadastrale	40m’/~6.50m’ -anësore /veri 40m’/7.25m’ – anësore / jug
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese bruto në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHP=30-40 % - S=980+240=1,220m ²
g. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHGJ=30%, parter – 735 + 180 = 915 m ² & 10% kulmi – 245 + 60 = 305m ² ,
h. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISPN=2.4 – S=5,880 + 1,440 = 7,320 m ²
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale	ISHPN=60% - S=1,470 + 360 = 1,830 m ²
j. Numri i hapësirave për vend parkime të automjeteve në kuadër të parcelës	56VP, në objekt + 5VP, mbi tokë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. Materialet në sipërfaqet e jashtme të ndërtesave të reja	Fasadë ventiluese -fasadë gjysmë strukturale
m. A ka qasje të pakufizuara në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/>	
n. shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe se sa zona për rreth? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	
o. A është ndonjë nga punët ndërtimore në Zona të Mbrojtura, Zona të Veçanta, ose Zona të Veçanta të Mbrojtura? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit Administrativ të MMPH Nr. 06/2017, dt. 23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Në të gjitha komentet që përcillen në adresën elektronike, të shënuar më lartë, të përshkruhet edhe numri i kërkesës, i shënuar në paragrafin 1 të këtij njoftimi publik.

Zyrtari: